



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Gjiçanit
Opština Gnjilane
Municipality of Gjiçan
Gilan Belediyesi

Procesverbal

I mbajtur në Seancën e gjashtë (VI) të Kuvendit të Komunës së Gjiçanit, mbajtur më datë 30.7.2015 me këtë:

REND PUNE

- 1 Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi procesverbalit të seancës së kaluar
- 2 **Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:**
 - 2.1. Raporti i punës i Kryetarit të Komunës për periudhën Janar- Qershor 2015
 - 2.2. Vendimin për caktimin e prioritetit në ndërtimin e institucionit parashkollor (Qerdhës së fëmijëve) në Lagjen “Dardania I”
 - 2.3. Raporti financiar Janar-Qershor 2015,
 - 2.4. Rekomandim i Komitetit për Shëndetësi dhe MS për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare: QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”
 - 2.5. Propozim vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01.Nr.16-24249 dhe Vendimit 01.Nr.16-24255 të datës 15.03.2013
 - 2.6. Propozim vendimi për emërimin e Komisionit për përcaktimin e Listës së Lokacioneve dhe hapësirave publike për vendosjen e Përmendoreve, Shtatoreve, Busteve dhe Simboleve, brenda territorit të Komunës së Gjiçanit
 - 2.7. Propozim vendimi për emërimin e Këshillit Komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i Komunës së Gjiçanit, tërësia etnike shqiptare dhe më gjerë
 - 2.8 Informatë rreth Manifestimit “Flaka e Janarit” 2015
 - 2.9 Informatë mbi aktivitetin gjashtëmuorë të KKS-së
- 3 Të ndryshme

Seanca i filloi punimet në ora 11.00

Në punimet e seancës së shtatë morën pjesë:
Anëtarët e Kuvendit
Kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri
Zv/kryetari i Komunës, z. Rexhep Kadriu
Drejtorët e drejtorive
Përfaqësuesi i OSB-së Irfan Ukshini
Përfaqësuesi i OJQ "Anamorava", z. Isa Shefkriu
Përfaqësuesi i Shoqërisë Cuvile, z. Shaban Terziu
Shefi i Zyrës Ligjore, z. Hevzi Matoshi
Mediet

Seancën e shtatë të KK-së e hapi dhe udhëhoqi kryesuesja e Kuvendit, zonja Valentinë Bunjaku-Rexhepi e cila fillimisht i përshëndeti anëtarët e Kuvendit, kryetarin e Komunës, z. Lutfi Haziri, zv/kryetarin e Komunës, Rexhep Kadriu dhe të gjithë të pranishmit e tjerë në seancë.

Në vijim të punës së seancës, kryesuesja kërkoi nga sekretari që të konstatohet prezenca e anëtarëve të Kuvendit në punimet e seancës së shtatë.

1. Konstatimi i prezencës së anëtarëve të KK-së dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar
Në punimet e seancës së shtatë ishin të pranishëm 34 anëtarë, kurse mungoi Fatbardh Selmani me arsyeje, sepse ka për ta mbrojtur temën e diplomës.

2. Rekomandimet e Komitetit për Politikë dhe Financa:

Kryesuesja e Kuvendit e hapi debatin përkitazi me rendin e punës i cili rend është dorëzuar me material të seancës në afat ligjor.

Sahit Abazi- ne fillimisht kërkojmë një informatë nga kryetari i Komunës përkitazi me përfitimet dhe dobitë të cilat iu janë sjellë Komunës, nga vizita e kryetarit të Komunës në SHBA? Kërkojmë informatë për deponitë e egra në Gjilan? Sipas informatave tona janë dhënë mjete për eliminimin e deponive të egra në periferi të qyteti, por këto deponi vetëm janë shtuar edhe më tepër!

Kërkojmë informatë për Teatrin për ta ditur se çfarë përparime ka pasur prej seancës së parakaluar, në të cilën seancë ne kemi kërkuar ndonjë hap emergjent për ta tejkaluar gjendjen në Teatër.

Një dukuri tjetër e cila ka filluar këto ditë janë spastrimet politike në të cilat nuk mund të quhen vetëm politike, por edhe profesionale në shëndetësi. Në shëndetësi është krijuar një gjendje jo stabile, sepse qëllimi është që të qetësohen dhe rehatohen militantët partiak. Në shëndetësi ka edhe kërcënime, sepse udhëheqësve të sektorëve u thuhet se ose largohuni vetë ose ne do të marrim masa! Lutja jonë është që të mos veproni në këtë mënyrë, sepse ka edhe institucione më përgjegjëse dhe këta njerëz mund t' i kthejnë në punë ashtu siç po i kthejnë edhe në administratë. Ne kërkojmë që të ndalet menjëherë ky spastrim politik në shëndetësi.

Një çështje tjetër brengosëse është ajo e qenve endacak për të cilët është thënë se do të merren masa për t' i mbrojtur qytetarët, por deri më tash nuk po vërejmë ndonjë hap konkret për eliminimin e kësaj dukurie. Këto vërejtje shërbejnë edhe për raportin e punës së juaj, por janë edhe pyetje për të cilat kërkojmë përgjigje?

Fehmi Sylejmani – unë pak ditë më parë kam dhënë vërejtje, sepse të gjitha komitetet një ose dy ditë para se të dorëzohet raporti i kanë mbajtur mbledhjet. Sa kanë kuptim ato mbledhje të komiteteve dhe ato rekomandime? A mund ato rekomandime ta ndryshojnë raportin e punës.

Deri më tash asnjëherë nuk e kemi parë që ndonjë raport me rekomandime nga komiteti të përcillet deri te kryetari? Raporti duhet të hartohet me rekomandime dhe të përcillet në adresë të caktuar, por kjo nuk po ndodh në asnjë komitet. Kjo punë që është kryer për dy-tri ditë është vetëm formale, sepse në esencë nuk ndryshon asgjë ?

Unë kam ngrit shumë çështje dhe ato i kam bërë me shkrim, por asnjëherë nuk kam marrë përgjigje, me përjashtim një përgjigje që e ka marrë nga drejtori i Shërbimeve Publike, z. Sokol Haziri, por në realitet dhe në praktikë nuk ka lëvizur asgjë.

Një kërkesë ia kam drejtuar DUMM dhe Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik dhe kryetarit, por kryetari ma ka kthyer përgjigjen të cilin e falënderoj publikisht. Kam pasur kërkesë për Shëndetësi, mandej për Buxhet dhe Financa .

Kërkoj një informatë për parkingun afër shkollave të mesme të cilin e shfrytëzon “Wiva fresh” ?

Riad Rashiti- unë kam dy pyetje, një kërkesë dhe një shqetësim. Pyetjet kanë të bëjnë lidhur me projektin e dezinfektimit i cili ka ndodh në pjesët më të ideshme të qytetit të Gjilanit, por kësaj here nuk po ndodh dhe nuk e dimë arsyen pse kjo nuk po ndodh?

Në vitin 2013 ky projekt ka kushtuar 7 mijë€ dhe ky dezinfektim ka ndodhur në tërë sipërfaqet e nevojshme të Gjilanit dhe në fshatrat ku ka qenë e nevojshme. Këtë vit është një vlerë jashtëzakonisht e madhe në vlerë prej 53 mijë, por përsëri dezinfektimi nuk po bëhet në tërë vendet ku është e nevojshme.

Pyetje e dytë është se çfarë po ndodh me projektet infrastrukturore, sepse ka shumë projekte të cilat janë bllokuar, por konkretisht pse nuk ka përfunduar trotuari nga Xhamia e Vogël në drejtim të Lagjes së Zabelit dhe nga Shkolla “Abaz Ajeti” në fshatin Velekicë? Ky projekt është kontraktuar para një viti, por ende nuk është realizuar?

Kërkojmë informacion nga kryetari i Komunës përkitazi me projektin e Varrezave të Dëshmorëve, sepse për këtë projekt është rishpall tenderi, por kanë kaluar dy vite dhe ky projekt nuk është realizuar dhe është bllokuar me arsyetim se janë duke u zhvilluar hetime. Kërkoj për ta ditur se a janë mbyllur hetimet dhe çfarë të metash ka pasur për këtë projekt, sepse është spekuluar mjaft për këtë projekt ! Kërkesa tjetër është që të diskutohet raporti i Auditorit të Përgjithshëm, sepse dihet se ka dal një raport me shumë shkelje ligjore të cilat janë bërë nga ekzekutivi i Komunës! Kërkojmë që të epet përgjigje për këto shkelje të cilat kanë ndodhur, sepse ndër të tjera është kërkuar nga kryetari i Komunës që t’ i fillojë hetimet për disa raste. Pyetja e ime konkrete është se a ka iniciuar kryetari i Komunës hetime për këtë çështje apo jo?

Bujar Nevzadi- i kam tri pyetje për kryetarin e Komunës; nën një çka po ndodh me Kompleksin e Shkollave të Mesme? E dyta a ka dal kryetari për ta parë Sheshin e prof. dr. “Xhavit Ahmeti”?

Unë propozoj ose të rregullohet ai shesh ose t’ i hiqet emri “Xhavit Ahmeti”! Si pyetje e tretë është që të më përgjigjet kryetari se çka po ndodh me Shtëpinë e Kulturës në Përlepnice? Projekti ka filluar para dy vite, por kryetari i Komunës e ka ndërprerë.

Një shqetësim e kam për kolegun tonë Shefik Selimi të cilin e kemi pasur shok së bashku me kryetarin e Komunës i cili tash është në gjendje të rëndë shëndetësore. Kryetari i Komunës e ka vizituar në shtëpi dhe i ka premtuar se bashkëshorten e tij do ta punësojë . Mirëpo ju pas dy muajve e keni larguar bashkëshorten e tij prej punës dhe këto ditë ka

qenë një vend i lirë i punës për edukatore në Dhe të Bardhë, por ju aty e keni punësuar një edukatore e cila i ka kushtet solide dhe një ndër më të pasurat në Gjilan. Unë nuk kuptoj këtë qeverisje, sepse punësohet njeriu i cili i ka kushtet më të mira në Gjilan, kurse njeri i cili i ka kontribuar çështjes kombëtare dhe tash është në gjendje të rëndë shëndetësore, bashkëshortja e tij mbetet e papunë! Kërkoj nga kryetari që të na jep përgjigje, sepse është i obliguar për të dhënë përgjigje.

Nevzad Isufi – në seancën e kaluar ka qenë një propozim për rendin e punës për ndërtimet pa leje e cila ka qenë kërkesë e shpeshtë e grupit të opozitës, por siç po shihet kjo çështje nuk është në rend pune as sot. Shtohet pyetje sa herë duhet bërë kërkesa dhe sa muaj duhet të kalojnë për ta përfillur një kërkesë legjitime të anëtarëve të Kuvendit?

Krenare Latifi- unë edhe më parë, por edhe në Komitetin për Shërbime Publike e kam theksuar se një ndër sfidat e kësaj qeverisje ka qenë edhe transporti urban. Drejtori i shërbimeve publike e ka thënë se ky projekt është i gatshëm, por pritet vetëm të zbatohet nga Zyra e Kryetarit. I bëj pyetje kryetarit edhe sa kohë duhet pritur për ta realizuar këtë projekt? Pse nuk zbatohet ky projekt kur po shihet se çfarë kaosi urbanistikë bëhet në qytetin tonë?

Isa Agushi- së pari Komisioni i Aksionarëve të Eco- Higjiensë i cili është formuar në këtë Kuvend asnjëherë nuk ka raportuar se çka po ndodh në Eco- Higjiensë?

Nën dy ne kemi rekomanduar edhe në Komitetin për Shërbime Publike, por edhe në Kuvend e kemi aprovuar që rruga prej Teatrit deri te Stacioni Autobusëve të mbyllet për automjete prej orës 19 deri në ora 23, por kjo nuk ka ndodhur dhe nuk i di arsyet pse nuk ka ndodhur?

U përmend edhe çështja e qenve endacak e për të cilin fakt unë kam shqetësim nga qytetarët në lagjen ku banoj, sepse qentë nuk po zhduken, por po shtohen. Për këtë dukuri kemi shumë probleme, prandaj kërkoj që të marren masa urgjente.

Leonorë Bunjaku- unë kam vërejtur se më në fund kanë filluar riparimet e rrugëve, pikërisht në kohën kur fluksi i qytetarëve dhe bashkatdhetarëve është më i madh. Sido që të jetë është mirë që po ndodh ky riparim, por duhet të jetë një periudhë kur frekuentimi i qyfterëve është më i vogël.

Një ndër rrugët më të degraduara është rruga në drejtim të Tregut të Gjelbër e cila rrugë ka një kohë të gjatë e cila nuk është riparuar. Ka tendenca që të bëhet edhe bllokimi i tërësishëm i kësaj rruge nga qytetarët, por edhe nga tregtarët.

Një tjetër dukuri e cila po e shëmtton qytetin është kundërmimi i Lumit Mirusha, sepse për të kaluar afër këtij Lumi dhe çdo qytetarë i cili kalon nëpër qendër të qytetit mund të kalohet vetëm me maska mbrojtëse kundër kundërmimit. Qytetarët të cilët jetojnë afër lumit Mirusha gjenden në hall të madh, sepse ato kurrë nuk i ajrosin shtëpitë e tyre.

Çështja tjetër është ajo e objektit të pylltarisë të kompleksin i shkollave të mesme ?

A keni ndërmarrë diçka që të largohet ky objekt për të qenë qarkullimi më i lehtë i nxënësve, arsimtarëve, por edhe qytetarëve. Për shkak të një objekti të degraduar aty e kemi një pamje të shëmtuar.

Nuk pari debatues dhe vërejtje tjera përkitazi me rendin e punës, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet ky rend i punës?

Aprovohet rendi i punës me 22 vota të anëtarëve të Kuvendit.

Procesverbali – Aprovohet procesverbali pa vërejtje me të gjitha votat e anëtarëve të Kuvendit

2. Raporti i punës së kryetarit të Komunës për periudhën, janar –qershor 2015

Lutfi Haziri- raporti i Komunës iu është dorëzuar organeve kompetente me kohë në mënyrë që përfshijnë në radhë të parë këshilltarëve të K K-së dhe KPF-së, sepse kërkesa ime ka qenë të zbatohet ligji, por kërkesë e imja ka qenë që t' i nënshtrohet edhe diskutimit nga të gjitha komitetet në mënyrë që seanca të jetë më e përgatitur më e informuar dhe më përmbajtjesore. Mirëpo propozimet që janë dhënë në komitet e që janë mbajtur para pak dite e që e theksoi z.Sylejmani, kjo seancë mund t' i përfshijë të gjitha ato pika që janë të domosdoshme e të cilat do t' i marrim përsipër vitin vijues për t' i rregulluar.

Raporti përfshin të gjitha aktivitetet e drejtorive dhe zyrave dhe përgjegjësve në zyrat e ekzekutivit, duke mos i paraqitur të gjitha detajet, por duke i pasqyruar gjërat e domosdoshme për të qenë i njoftuar organi më i lartë i Komunës gjegjësisht KK.

Në raport paraqiten edhe sfidat konkrete gjatë punës, programit të përbashkët sipas planit që është miratuar dhe sipas agjendës politike komunale.

Në vijim të fjalës së tij kryetari i Komunës gjatë fjalës së tij dha informacione të plota për sukseset të arritura, por edhe sfidat me të cilat është ballafaquar ekzekutivi i Komunës e të cilin raport të gjithë anëtarët e Kuvendit e posedojnë si material me shkrim.

Sahit Abazi – kryetarin e dëgjova e me vëmendje, por ai fare nuk m' u përgjigj për deponitë e egra dhe as për qentë endacak.

Riad Rashiti- e përshëndes këtë raport, sepse kryetari është i obliguar për te raportuar, kurse ne si PDK, këtë raport e vlerësojmë si jo te besueshëm dhe jo real për shume arsyeje, sepse ne përmbajtjen e tij e vlerësojmë se ne këtë raport me tepër ka pasur tendenca për ta mbuluar mos punën dhe dështimet ne shume sektorët te qeverisjes Komunale te Gjilanit. Në kohë të fundit kemi pasur shumë pak informacione për punën e kryetarit. Se pari po filloj nga Çështja e buxhetit e cila është prezantuar në këtë raport i cili buxhet është paraqitur ne bazë tërë asaj qe është planifikuar, mirëpo ne nuk po e shohim askund se Gjilanit iu janë thyer kufijtë buxhetor gjate vitit 2015 në vlerë prej 2.4 milion €. Ne kemi shumë deklarata publike, zotime dhe pretime se Komuna e Gjilanit i ka thyer kufijtë buxhetor për herë të parë në vlerë prej 4 milion e 200 mije €. Këta kufij buxhetor nuk janë thyer dhe nuk shihet se ka ndodhur, por edhe ka shumë arsyeje pse nuk janë thyer kufijtë buxhetor. Mandej është thënë se me rishikim te buxhetit do të ndodh thyerja buxhetore, por as me rishikim te buxhetit nuk ka ndodhur. Ky është një premtim, por është një dështim total, sepse nuk është rritur buxheti i Komunës së Gjilanit për asnjë cent!

Sa i përket çështjes se ekonomisë dhe punët te cilat i keni paraqitur në këtë gjashtë mujor ne si grup i PDK-se, nuk po e vërejmë asnjë projekt për këta gjashte muaj qe është realizuar (projekt i rëndësishëm) dhe nuk e dimë që ka ndonjë risi nga qeverisja e juaj dhe jo që nuk është realizuar, por as qe është hartuar.

Ne si qeverisje e kaluar i kemi pasur disa projekte në bashkëpunim me PPP-në, por në këtë qeverisje janë bllokuar te gjitha këto projekte dhe asnjë €, nuk është investuar përmes PPP-se e cila metode dhe mënyrë e investimeve ka qene shume e suksesshme gjate qeverisjes se PDK-se, sepse janë realizuar disa milionë euro. Mirëpo në këtë qeverisje këto nuk po ndodhin edhe ato projekte te cilat janë te nënshkruara si është rasti me Eco-Higjienën. Gjithashtu edhe projekti i kompleksit te shkollave te mesme ka qene i gatshëm

dhe ka qene e nevojshme vetëm qe te nënshkruhet kontrata, mandej ka qene transporti publik, Tregu i Gjellbër. Këto janë katër projekte te rëndësishme për të cilat projekte asnjë lëvizje e vetme nuk është bere dhe ende nuk kemi arrit ne fazën ku ne kemi qene ne fund te vitit 2012. Po ashtu është bllokuar projekti i Zonës Ekonomike, sepse asnjëherë nuk është thënë se ku gjendet ai projekt? U përmend edhe projekti i Lumit Mirusha, për te cilin kërkoj shkurtime te cilin projekt ju e keni hartuar, por ka qëndruar me vite ne sirtarë te drejtorive derisa ne kemi ardhur në pushtet në të cilin mandat ne i kemi investuar 3 milion €, kurse tash kanë kaluar 1.5 vjet dhe nuk është investuar asnjë € në këtë projekt! Ku janë premtimet, nga ministrat e juaj, nuk ka asnjë lëvizje për këtë projekt .

Sa i përket infrastrukturës dhe urbanizmit ne raport nuk është thënë asgjë për problemin te cilin e ngriti kolegu nga LVV për ndërtimet pa leje. Pse z. Kryetar nuk po ndodh për këta muaj asnjë reagim i vogël edhe simbolikisht për ta ndaluar së paku një ndërtim pa leje?

Është një listë e gjërë e projekteve te qytetit dhe lagjeve, por për herë të parë po e ngris Çështjen e fshati Malisheve, Uglar dhe Pogradje, sepse ne listën tuaj askund nuk shihet ky projekt për këto fshatra edhe pse asnjë € investim nuk është bere ne këto fshatra. Anët pozitive janë te lista e projekteve te rrugët e rendit te trete, sepse janë bere përpjekje për t' i mbajtur rrugët e rendit te tretë. Mirëpo edhe në këto rrugë të rendit të trete janë disa shifra qesharake , sepse ne fshatin Bresalc është një projekt prej 18 metra gjatësi, kurse ne fshatin Çelik shihet se shume pak është punuar. Te Drejtoria e Bujqësisë është theksuar se është punuar mjaft, por ne realitet është vazhdimësi e punëve te kaluara .

Sa i përket raportit te Auditorit te Përgjithshëm, kryetari e tha se ky është draft raport, por nuk është e vërtete se ky është draft-raport , por është raport përfundimtar të cilin e ka hartuar në bazë të te gjeturave Auditori i Përgjithshëm. Ju z. Kryetar këtë raport e cilësoni si raport i paragjykuar me te cilin konstatim tuajin, ne si grup i PDK-se nuk pajtohemi, sepse është raport profesional në të cilin është punuar gjatë. Për neve ky raport është shqetësues , sepse janë dhëne vërejtje për Komunën e Gjilanit, sepse merren vendime jo ligjore dhe e dëmton buxhetin dhe paranë e qytetareve te Komunës se Gjilanit.

Në këtë raport thuhet se kontrolli i menaxhmentit dhe kontrollit financiar dhe në këtë raport konstatohet se Komuna e Gjilanit nuk e zbaton ligjin për dhënie te pasurisë komunale, për të cilin rast janë përmendur disa raste. Po ashtu janë theksuar edhe grande te cilat kanë ardhur nga jashtë në vlerë prej 220 mije € e të cila mjete nuk janë shpenzuar me kohë. Kontratat për dhënie ne shfrytëzim prej te cilave janë 34, por nuk është bërë procedura e hapur ligjore për dhënie ne shfrytëzim te pronave. Komuna e Gjilanit i ka humbur 163mije € si pasoje e moszbatimit te legjislacionit për pasuritë komunale.

Te sektori i prokurimit thuhet se janë 120 procedura te prokurimit në vlerë prej 5 milion e 500 €, shpenzime te bëra përmes prokurimit. Një numër i procedurave është se disa procedura nuk janë paraparë ne Sektorin e Prokurimit dhe nga kjo del se edhe në këtë sektor nuk ka plan të qartë dhe i cili fakt thuhet në raport të Auditorit.

Ne shqetësim e kemi edhe çështjen e tenderëve në Komunë të Gjilanit dhe disa herë kemi bërë pyetje, sepse edhe nga Auditorit thuhet se janë zhvilluar në të njëjtën kohë dhe me të njëjtin operator ekonomik nga disa raste për te njëjtin shërbim dhe furnizim. Është përmendur rasti kur katër tender iu janë dhëne te njëjtës kompani dhe janë dhenë 4 tender për te njëjtin projekt dhe kjo është një çështje alarmante, sepse e dëmton rëndë buxhetin komunal.

Ne fund po theksoj se te Sektori i Kulturës, Rinise dhe Sportit subvencionet të cilat po epen nuk janë te monitoruara e te cilat iu kanë ndarë OJQV-ve dhe subjekteve tjera.

Ju keni kërkuar që të mbyllen subvencionet të cilat i ka dhënë qeverisja e kaluar, por me te njëjtin ritëm keni vazhduar dhe po vazhdoni qe ky sektorë te ndajë subvencione duke mos ditur se për çfarë qëllimi po i jep?

Si përfundim po e theksoj se kjo qeverisje ka dështuar plotësisht në të gjitha sektorët, sepse jo që ka realizuar ndonjë projekt kapital, por ka dështuar edhe në vazhdim të projekteve të qeverisjes së kaluar. Është e nevojshme të bëhet riformatimi i qeverisë ashtu siç ka deklaruar kryetari shpesh, sepse, kjo qeverisje ka dështuar plotësisht.

Bujar Nevzadi- unë do t' i them disa gjera, por po theksoj se asgjë private me kryetarin nuk kam, por të gjitha ato që do t' i them qëllimin e kanë për një qeverisje me të mire. Se pari në raport nuk thuhet asnjë fjalë për problemet të cilat janë aktuale në qeverisje, për sfidat dhe planet për të ardhmen, sepse kryetari nuk ka dorëzuar plan para Kuvendit. Kryetari nuk e tha asnjë fjalë për Drejtorinë e Urbanizmit. Nuk u tha asgjë për Inspeksionin dhe as që u përmend! Gjithashtu nuk u tha asgjë për kulturën ! U përmend kompleksi të shkollat e mesme, por ju nuk mund ta realizoni atë kompleks , sepse atij zotërisë të cilit i keni dhënë leje për ndërtim të një objekti e keni shkatërruar atë kompleks.! Ai person ka pritur 5 vjet në qeverisjen e PDK-së dhe nuk ka marrë leje, por ka pritur derisa të vijë një njeri të cilin e blen dhe e ndërton objektin. Ne mund të dalim dhe ta shikojmë dhe ta shohim se si është shëmtuar ai kompleks i shkollave.

Ju në qeverisjen e kaluar e keni shëmtuar Dardaninë me një objekt, e keni shëmtuar pjesën e qyteti afër spitalit e keni shëmtuar qytetin në Dheun e Bardhe. Ju nuk keni guxim nuk keni vullnet, por ndoshta edhe dije për t' i ndal këto shëmti. Ju me qëllim e keni shuar Drejtorinë e Inspeksionit dhe në këtë mënyrë është krijuar kaos në qytetin e Gjilanit. Për këto gjera dikush duhet të marrë përgjegjësi. Edhe projektet e tjera nuk do të përfundojnë, sepse kryetari nuk ka kohë për t' u marrë me këto gjera, sepse kryetari me tepër reshte angazhuar si ministër i punëve të jashtme. Për zyrtaret me kontratë në vepër është bërë mjaft zhurmë nga ana e kryetarit, por kryetari ka vazhduar me këtë avaz dhe një numër i konsiderueshëm i punëtorëve është i punësuar në këtë mënyrë.

Për Pendën e Perlepnices, kryetari jep deklarate se nuk është përgjegjësi e tij, kurse në anën tjetër ka deklaruar se do të ketë ujë 24 ore. A mund ta kuptojë dikush sa deklarate e papërgjegjshme është ajo? Një parking e ka pasur Komuna e Gjilanit, por në këtë kohë kur vijnë në pushime njerëzit tanë, aty janë vendosur lojërat e fëmijëve për pak para? Kryetari duhet të ruhet nga fjalët e mëdha, por me rastin e deklarimit të pasurisë, kryetari i Komunës së Gjilanit ka dalë që të jetë një nder kryetaret me të pasur në Republikë të Kosovës, kurse në anën tjetër dihen të ardhurat e tij. Unë kam pyetje nga cili burim u krijua ajo pasuri? E lus kryetarin ta kompletojë qeverisjen, sepse për 18 muaj nuk është kompletuar qeverisja, prandaj çka mund të presim me tepër nga kjo qeverisje?

Nevzad Isufi – së pari po theksoj se ndoshta nuk ka nevojë ta theksojmë nenin 4. 7 pikën a dhe b në të cilin nen dhe pikë përcaktohet se sa lejon rregullorja që ta ketë fjalën një anëtar i Kuvendit, sepse nuk po respektohet rregullorja dhe nuk po ka konsiderate edhe për të tjerët.

Sa i përket raportit të kryetarit është një nder çështjet më të ndjeshme për një vit pune të Kuvendit, duke përfshirë edhe punën e raportit vjetor, sepse në këtë gjashtë mujor ka mundësi për përmirësim të vërejtjeve dhe sugjerimeve nga anëtarët e Kuvendit.

Çështja e këtij e raporti se pari është me rëndësi se çka është punuar për 6 muaj, cilat kanë qenë çështjet prioritare, cilat janë realizuar me afat dhe cilat kanë ndikuar në lehtësimin dhe përmirësimin e jetës së qytetareve. Zakonisht kur kryhen punët mirë, ato flasin vetë dhe i ikim përgjegjësive për të diskutuar gjatë, prandaj me të drejtë quhet raport i punës së kryetarit dhe jo informate dhe as ligjëratë e kryetarit. Nga shqyrtimet e deritashme disa

raporte ndodh që janë tepër njëformëshe dhe ne baze të kësaj atë e përgatitin të nijetit njerëz, apo kanë krijuar një lloj modeli nga i cili e kanë vështirë të dalin.

Ne raport me shumë rendësi janë shifrat, por për ne është me rendësi se si kemi arrit deri te ato shifra për të u bindur se çdo gjë ka shkuar mirë dhe si duhet? Me një fjalë duhet ta kemi një raport të shkurtër, të qartë, konkrete. Raporti për buxhetin me shifra dhe përqindje është ashtu si duhet, mirëpo po të ndiqej edhe nga dikasteret e tjera do të ishte shumë me mire. Mund të them se edhe në raportin për bujqësi ka elemente të tilla dhe në atë të Administratës dhe Shërbimeve Publike.

Pas kësaj fillohet me teorizime ku flitet me Komitetin për Bashkëpunon Ndërkombëtar e që duket se bëhet fjalë për Qeverinë qendrore dhe jo për Qeverinë komunale, prandaj nuk duhet harruar se jemi duke diskutuar për një qeveri komunale. Përmenden projekte nga organizatat ndërkombëtare, por prej tyre vetëm një është konkretizuar, ai panairit të Gjilanit i vitit 2015. Mirëpo këtu përmenden edhe projekte me rendësi e që kapin shumë prej 24 milion € e që do të ishin tejet me vlerë në Komunën tonë, por për ato projekte është mbajtur një konferencë me dhuruesit, por nuk ka asnjë shenjë se kur do të fillojnë të realizohen. Tash për tash ato projekte mbeten dëshira që i referohen një të ardhme me kohë të pacaktuar! Ashtu qëndron puna edhe me programe për bashkëpunim ndërkufitar (programi për Kosovën e Bukur), si është rasti me parkun “Dardania” për të cilin edhe ka përfunduar faza e tenderimit qysh në qershor, por ende nuk ka shenja se do të fillojnë punimet. Edhe dy projekte me shumë rendësi nuk kanë filluar si është ajo e projektit universitar, sepse ne kemi nevojë për hapësirë të Universitetit, por po ashtu kemi nevojë dhe për terrene sportive, për të cilat sipas raportit qenkan në proces. Mirëpo nuk duhet harruar se disa procese zgjasin deri në pafundësi. Te Administrata thuhet se po rritet efikasiteti në shërbime, por me shifra dhe krahasime nuk është paraqitur asnjë e dhënë.

Te pika e 4 e raportit janë përfshirë në një vend arsimit, shëndetësia dhe kultura e cila përfshin pak me tepër se gjysmë faqe. Ka shumë pak fjale për arsimit, shëndetin dhe infrastrukturën, behet fjale për disa manifestime kulturore, kurse Teatri nuk figuron askund edhe pse e dimë se në çfarë gjendje është Teatri?

Ne pikën 5 të raportit është folur për Urbanizmin dhe kryesor ka qene mirëmbajtja verore e rrugëve, por kjo punë bëhet në kohë të papërshtatshme dhe me vonesë, por jo edhe me cilësi të duhur. Te puna e drejtorive do të veçoja se janë kryer shumë aktivitete dhe projekte, por me rendësi është se a do të behet realizmi i tyre? Kemi pilot projekte të cilat ende nuk kanë gjetur zbatim, por me shumë i referohen së ardhmes. Sa i përket sektorit të Inspeksionit ne e kemi tërheq vërejtjen me kohë për shuarje të kësaj drejtorie edhe sektorëve të tjerë, posaçërisht atij të ndërtimit. Raportit i mungon një qasje e cila do të ishte qenësore për punët e kryera deri më tash e jo vetëm fjalë për të ardhmen.

Raportit duhet shtuar edhe planet, por edhe punët e kryera deri më sot. Në raport do të ishte mirë të ishin edhe disa vlerësime kritike dhe sfidat gjatë punës së tij.

Mungesa e Drejtorisë së Inspeksionit ka ndikuar që në Urbanizmi të kemi të hyra shumë më të vogla në krahasim me ato që janë paraparë?

Në raport nuk përmendet çështja e zyrtarëve me kontratë në vepër, nuk përmendet askund, nuk përmendet çështja e rehatimit të disa familjareve të anëtareve të Kuvendit, mandej transferimi nga një vend në vendin tjetër pa konkurs. Nuk theksohet askund edhe çështja e ndërrimit të drejtoreshave pa konkurse e që janë mangësi dhe shkelje të mëdha ligjore.

Fehmi Sylejmani – unë me tepër do ta vë theksin në Sektorin Arsimit për të cilin rast edhe më parë, por me konkretisht dhe e kemi diskutuar këtë temë me qellim shumë të mirë dhe në dobi të arsimit për të qenë cilësia e arsimit në nivel të duhur. Fillimisht po theksoj se arsimit në nivelin 9 (nëntë) vjeçar është në ngritje me të cilin konstatim po pajtohem, por në

shkolla te mesme nuk e kemi këtë fakt. Ajo që nuk është në rregull sipas meje janë subvencionet e që janë paraparë 50 mijë € e që janë ndarë për nxënësit shkollës së Agro-biznesit, por me këto subvencione nuk do të këtë bursa për studentë. Është mirë të dihet nga ana e kryetarit se me këto subvencione, studentët nuk mund ta gëzojnë këtë të drejte. Atë që e tha kryetari për kompleksin e shkollave të mesme nëse me të vërtetë ne pajtohemi, por unë do ta ngrisi një çështje me këtë rast dhe nëse ndodh ashtu që të transferohet Universiteti “Kadri Zeka”, atëherë nuk kemi nevojë ta ndërtojmë Shkollën e Artit Pamor. Këtë po e them, sepse shkolla e Artit Pamor nuk është ndonjë drejtim perspektivë dhe në një kohë jo të gjatë duhet të ndërpritet.

Shkolla në fshatin Haxhaj sipas komisionit vlerësues nuk i plotëson kriteret për t’u zhvilluar procesi edukativo-arsimor, sepse është shumë e dëmtuar. Salla të edukatës fizike janë vetëm dy, por vazhdimisht po e përmendi se më së tepërmi po i bëhet e padrejtë Shkollës “Rexhep Elmazi”. Në këtë shkollë janë dy mësimdhënës të edukatës fizike e të cilët janë jo vetëm në Gjilan, por edhe më gjerë janë më të mirët, sepse njëri është legjendë e futbollit, kurse tjetri sportist i atletikës me përmasa botërore. Këtyre sportistëve të mos ia mundësojmë që të mos e bartin dijen e tyre tek të rinjtë, mendoj se është një mëkat.

Në raportin e kryetarit nuk janë paraparë pajisjet kabinetike të shkollave. Janë paraparë mjaft projekte për të ardhmen, por nuk e di a është menduar se duhet larguar edhe stadiumin nga ajo pjesë, sepse nëse zbatohet projekti i kompleksit të shkollave të mesme, stadiumi do të jetë pengesë. Mos shpallja e vendeve të lira të punës u përmend, por ka edhe transferime nga një shkollë në shkollën tjetër e të cilat procedura janë të paligjshme.

Pyetje është për kryetarin se a është në dijeni kryetari se në Drejtorinë e Arsimit punon një zyrtar pa diplomë dhe pa konkurs!? Nëse nuk jeni në dijeni duhet ta hulumtoni dhe ta vërtetoni se kush është dhe prej cilës kohë është i punësuar ai person?

Sa i përket zgjedhjes së drejtorëve është një konflikt në mes të Drejtorisë së Arsimit dhe Ministrisë së Arsimit dhe kjo çështje duhet të rregullohet sipas udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit. Regjistrimi i nxënësve në klasë të parë nuk është bërë sipas rregullave, kurse sa i përket klasave të dhjeta, mendoj se nuk ka pasur parregullsi. Nuk e di se a është në dije kryetari se Drejtoria e Arsimit i ka vizituar disa shkolla dhe me atë rast janë bërë disa dënime dhe ajo vlerë e dënimeve ka arrit në vlerë prej 10 mijë €. Ne e kemi përkrah këtë iniciativë, por Drejtoria e Arsimit ka bërë shkelje të procedurave, sepse i ka dënuar të gjithë ata mësimdhënës pa ndonjë vërejtje paraprake dhe pa i zbatuar procedurat e rregullores.

Unë propozoj që në ato shkolla ku ka më së shumti mungesa të mësimdhënësve, drejtorët të shkarkohen ose të merren masa ndaj tyre.

Një kërkesë e studentëve është që biblioteka e qytetit të punojë deri në ora 19, sepse ajo aktualisht punon deri në ora 16. Në fund kërkoj që kryetari të na e jep një sqarim për Festivalin e birrës i cili po mbahet dy vite me radhë në Gjilan, kurse ne në shkollat ku punojmë i edukojmë fëmijët se alkooli është i dëmshëm. Ky festival në Gjilan nuk koïncidon me ndonjë fabrikë ose prodhim dhe unë mendoj se ky festival në tërësi nuk ka kuptim dhe është i gabuar, sepse me këtë rast nuk përfitojnë as bizneset e Gjilanit, por përfiton dikush tjetër, prandaj ky festival nuk duhet të mbahet në Gjilan.

Izmi Zeka – sa i përket raportit është më mirë që qeverisja e kaluar të mos përmendet shpesh, sepse jemi lodhur duke na thënë se ka qenë kështu, kurse tash e kemi ndërruar qasjen. Në raport thuhet se do të bëjmë, do të veprojmë, por gjëra konkrete nuk ka? Unë e kam thënë edhe më herët se është mirë ta dimë se cili është planifikimi i Komunës, kurse në fund të gjashtëmujorit, gjegjësisht nuk fund të vitit të shohim se çka është realizuar?

Kryetari më tepër foli në vija të trasha, por në Gjilan nuk është realizuar ndonjë projekt i madh dhe nuk është bërë ndonjë investimi cili duket.

Çështjet e brendshme të qeverisje komunale, janë çështje të kryetarit të Komunës, sepse e ka një mandat ia kanë dhënë qytetarët e Gjilanit, ta mbajnë mandatin dhe mos ta politizojnë Komunën.

Kryetari duhet të kujdeset për atë që e tha shefi i grupit kuvendar. Katër shefa që janë larguar nga QKMF-ja janë të PDK-së, prandaj po pyesim pse largohen ata njerëz? Unë po e them shumë qartë ata janë të PDK-së dhe po largohen, prandaj po e shtroj pyetjen pse largohen ata shefa? Nuk është etike të ndërrohen ata shefa pa argumente! Unë jam për të bërë reforma, por ato të bëhen në kuptimin më pozitiv, sepse duhet t' i ruajmë njerëzit. Unë këso veprime destruktive nuk mund t' i përkrahi po e them shumë qartë se lëvizjet e tilla të kuadrove të cilët janë profesionist nuk mund t' i përkrahi.

Ky raport për mua është teori, por edhe ato që i tha kryetari për fushatë janë të mira, për marketing vlejné, por edhe për opinion për gazeta dhe portale do të jenë shumë mirë të shkruara. Gjërat duhet të jenë konkrete. Ne si opozitë po diskutojmë po japim propozime, vërejtje, sugjerime, por asgjë nuk merret parasysh.

Projektet që kanë filluar mos të harrohet se ato duhet t' i vazhdojë dikush, sepse edhe kjo qeverisje kur të mos jetë një qeverisje që vije duhet t' i vazhdojë.

Sa i përket kursimeve, unë jam për të kursyer, por jo në dëm të angazhimeve të punës dhe jo në dëm të projekteve. Nëse bëhet pyetje a ka diçka pozitive, është e pamundur për pa pasur diçka pozitive, sepse kjo është Komunë dhe ndryshon, lëviz diçka dhe i ka edhe anët e mira. Mirëpo qasja si e proklamoi z. Haziri në praktikë nuk është, në teori është i mirë. Po ta dëgjojmë kryetarin e Komunës duket se çdo gjë është në rregull. E lus kryetarin që të punojmë me sinjeritet dhe sa mundemi, kurse ne e ndihmojmë si opozitë për qat sa na përfillni.

U përmend raporti i Auditorit dhe unë e kam parë atë raport, për të cilin raport na keni bërë kritika vazhdimisht, tash në këtë raport kishte gjëra të cilat nuk na kanë ndodhur neve.

Mirë do të ishte që të shikohen për të ardhmen rrugët kryesore të qytetit si këtë të Prishtinës, të Ferizajt, Preshevës etj. Uroj që gjashtëmujori i dytë të jetë më i mirë se ky dhe uroj që të punohet mirë për interes të qytetarëve dhe grupacioneve politike.

Për fund po i përmendi edhe lejet e ndërtimit, prandaj është mirë z. Kryetar për ta parë qytetin, sepse nuk ka qytetarë që nuk flet për ndërtime pa leje. Këtë nuk po e them nga ana partiake, por është mirë të silltet një raport për të diskutuar se si të dilet nga kjo situatë dhe si të gjendet një zgjidhje? Për fund iu falënderoj dhe uroj që gjashtë mujori i dytë të jetë më i mirë!

Arijetë Rexhepi – unë i kam disa vërejtje të Drejtorisë së Kadastrit dhe Gjeodezisë, por edhe të Drejtorisë së Urbanizmit. Raporti është përshkrim i dobët i disa punëve se sa përshkrim serioz i punës së drejtorive. Përgjithësisht ka përshkrim, por jo të dhënë të detajizuara të cilat do të na shërbenin neve si anëtarë të KK-së për një informim sa më të plotë dhe të drejtë.

Në raport të Drejtorisë së Kadastrit i kemi vetëm tri faqe raport dhe në këto tri faqe janë theksuar vetëm tri raste të uzurpimeve, parcelime janë 41, kurse parcelime dhe punë të tjera në sektorin privat janë 203. Sa i përket parcelimit ka ngecje, me procedura të rrugës Gjilan- Prishtinë dhe njëra nga zonat kadastrale është që nuk i takon Komunës sonë, por i takojnë Komunës së Artanës.

Sa i përket shpronësimeve është një shumë e madhe për t' u paguar, por për këtë periudhë janë paguar pak më shumë se 48 mijë €. Nëse vazhdojmë me këtë tempo të kompensohet shpronësimi, atëherë nuk dihet sa kohë na duhet për t' i kryer këto obligime. Detyrë tjetër e

kësaj drejtorie dhe ajo kryesore është se ka të bëjë me uzurpimin e pronave publike. Mirëpo brenda gjashtë muajve unë nga kjo drejtori e kam kërkuar listën me emra të uzurpatorëve të pronave publike. Si përgjigje më është thënë se listën mund ta lexoj, por lista nuk mund të më epet si kopje fizike! Për këtë arsyeje shtrohet pyetja kur kjo drejtori nuk është transparente me anëtarët e Kuvendit, atëherë si mund të jetë me qytetarët.

Ne kërkojmë nga kjo drejtori që të na i sjell emrat e uzurpatorëve të pronës publike. Në Drejtori të Urbanizmit është bërë shumë pak punë, kurse në anën tjetër rritet numri i ndërtimeve të egra. Në faqen 20 të raportit përshkruhet puna e inspektorëve të ndërtimit e të cilët në terren dalin me fleta të bardha dhe jo me fleta të posaçme të procesverbalit e cila dukuri len përshtypjen se mund të manipulohet me këto procesverbale.

Zijadin Maliqi- raporti i kryetarit është dhënë në vija të trasha, kurse drejtoritë përkatëse i kanë dhënë raportet e tyre detale me të dhënë konkrete e që besoj se janë shumë reale. Kryetari ka mund ta jap raportin vetë, por për mua është shumë më mirë këtë formë të cilën e ka zgjedhur kryetari që në vija të trasha e ka dhënë këtë raport, pastaj drejtoritë përkatëse i kanë dhënë raportet e veta e të cilat janë shqyrtuar edhe në komitete përkatëse për aprovim e cila procedurë është shumë në rregull. Përveç raportit kryetari edhe informata të tjera e që janë me shumë rëndësi për anëtarët e KK-së. U tha nga kryetari se buxhetin e Komunës duhet ta menaxhojmë ashtu si duhet, sepse janë të hyra të qytetarëve të Gjilanit dhe të qytetarëve të Kosovës. Mirëpo është me shumë rëndësi rritja e donacioneve nga donatorët e huaj e që në bazë të prezantimit të kryetarit është mjaft e mirë. Secila Komunë duhet të aplikojë për donacione të ndryshme dhe në këtë pikë kemi rezultate konkrete, mirëpo priten rezultate shumë më të mëdha në të ardhmen. Për buxhetin nuk do të flas, sepse e kemi si pikë të veçantë, por disa herra u përmend thyerja e kufijve buxhetor. Mirëpo kufijtë buxhetor, grandit i Qeverisë që ndahet për komuna nuk mund të thyhet., sepse është formula e përcaktuar për ndarjen e grandeve. Thyerja e kufijve buxhetor është bërë në buxhetin e Kosovës përmes ministrive të caktuara, sepse janë thith mjete për realizim të projekteve.

Në vitin 2014 nuk kemi pasur asnjë projekt i cili është realizuar përmes ministrive, por tash i kemi disa projekte të cilat do të realizohen përmes ministrive përkatëse.

Sa i përket ndërrimit të shefave në sektorin e Shëndetësisë po theksoj se edhe unë nuk jam për atë që të bëhet ky ndërrim, por duhet shikuar edhe zanafillën se si kanë ardhur këta shefa të PDK-së.

Duhet shikuar a janë profesional këta shefa dhe nëse janë profesional edhe unë jam që mos të ndërrohen. Shtrohet pyetja se si u zgjodhën këta shefa të gjithë nga PDK-ja? Nga kjo shihet se në këtë mënyrë është vepruar edhe më parë e që për mua nuk është në rregull.

Ne si grup i anëtarëve të LDK-së e përkrahim këtë raport, sepse është një raport gjithëpërfshirës, me ambicie që të punohet edhe më tepër dhe më me efikasitet në gjysmën e dytë të këtij viti.

Selami Xhemajli- së pari një vërejtje të lehtë, sepse gjatë punës së seancës duhet pasur parasysh efikasitetin e punën dhe të punohet sipas rregullores së punës.

Për vlerësimet e raporti, vërejtjet duhet t' i japin shefat e grupeve në mënyrë që të jemi më efikas. Sa i përket raportit është obligim sipas ligjit të Vetëqeverisjes lokale për të raportuar kryetari, prandaj unë e vlerësoj këtë në emër të grupit të AAK-së dhe i kemi dhënë mbështetje këtij raporti edhe në KPF, por edhe këtu si grup e përkrahim në parim këtë raport me vërejtjet dhe sugjerimet të cilët dolën nga anëtarët e Kuvendit. Ajo çka mund të vlerësohet është se ky raport teknikisht dhe profesionalisht ky raport është mirë i përgatitur, sepse krahas punës së ekzekutivit dhe Zyrës së Kryetarit i kemi edhe raportet e punës së

drejtorive. Vërehet se në sektorë të caktuar kemi edhe ngritje të performancës. Me vërejtjet, sugjerimet të cilat u dhanë nga anëtarët e Kuvendit ne e përkrahim raportin gjashtë mujor të punës së kryetarit të Komunës.

Leonorë Bunjaku- unë kam vërejtje në Drejtorinë e Arsimit, sepse është bërë ndalesë e pagës të disa arsimtarë i cili vendim ka qenë shumë i padrejtë dhe i ngutshëm, sepse nuk është dhënë dhe nuk janë marrë informacione të mjaftueshme për mungesat e arsyeshme si nga ana e drejtorëve, por edhe nga ana e mësimeve. Kjo është pasojë e mos punës së juaj dhe inspektorëve në kontinuitet. Këto vërejtje ka qenë desh të bëhen qysh nga fillimi i vitit shkollor së pari duke dhënë vërejtje me gojë e pastaj me shkrim. Mirëpo kjo ka ndodhur në fund të vitit shkollor dhe do të thotë se iu është ndaluar shuma totale në fund të vitit e që është një formë e gabuar, sepse 50 € për një muaj janë të mëdha për buxhetin e secilit mësues. Ne jemi kundër mospunës, por ka forma të tjera të ndëshkimit dhe kjo ka qenë deshtë të ndodh në çdo muaj, duke i heqë një apo dy mëditje në secilin muaj që ka munguar arsimtari, por kjo ka ndodhur në fund të vitit dhe për mua është veprim i papranueshëm.

Lutfi Haziri-pas të gjitha këtyre debateve në fund e mori fjalën edhe kryetari i Komunës, z. Lutfi Haziri i cili u përgjigj në të gjitha pyetjet, vërejtjet dhe sugjerimet e anëtarëve të Kuvendit.

Nuk pati debatues të tjerë lidhur me raportin e punës së kryetarit të Komunës, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet ky raport ?

Aprovohet raporti i punës së kryetarit të Komunës, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, 5 ishin kundër, kurse të tjerët abstenuan.

2.2.Vendimin për caktimin e prioritetit në ndërtimin e institucionit parashkollor (Çerdhes së fëmijëve) në Lagjen “Dardania

Lutfi Haziri- nga na e juaj ky projekt është vendos është në plan urban është në rregullativë, kurse neve na duhet një vendim formal për prioritet për arsye që të kompletohet dosja në programin që e thash më herët “Qeverisje për qeverisje” me USAID-in Amerikan. Kanë qenë tri programe në konkurrencë, por është vendos që në prioritet të jetë “Dardania I” dhe në këtë rast duhet një votim formal për t’ i dhënë mbështetje këtij programi.

Fehmi Sylejmani- së pari fjala çerdhe shkruhet me “Ç” dhe “Q”. Sa i përket këtij projekti është mirë të dimë se sa do të kushtojë, sa është kapaciteti i kësaj çerdhe dhe informata të tjera nëse ka mundësi? Ne këtë propozim e përkrahim, sepse është në interes të qytetarëve tanë.

Lutfi Haziri- si çdo projekt tjetër edhe ky është i propozuar në bazë të iniciave, sepse është projekt ideor, kurse projekti do të bëhet pasi që të konfirmohet këtu dhe do të jetë i gatshëm. Pretendohet që të jetë dykatëshe edhe për dy grup mosha të fëmijëve, prej 03-deri në 06 me një personel të bartur apo të dekoncentruar nga stafi tjetër për shkak të limiteve që i kemi në punësim.

Grandi i Qeverisë Amerikane është 200 mijë dollarë, kurse Komuna merr pjesë në programin shtesë për atë sa ka nevojë projekti për t’ u realizuar, por jo më shumë se sa keni ne potenciale. Realisht duhet të jetë pjesëmarrja 10-20% pasi që të kryhet projekti ideor.

Bajram Hasani- sot mora informacion se ne në Kuvend e kemi kaluar para disa muajve projektin e parkut “Dardania”, mirëpo unë kam pasur informacione se ka pasur pengesë në rritjen e shumës për zgjerim të projektit (shumës) në mes donatorit dhe institucionit ose Komunës dhe për këtë arsyeje nuk po zbatohet. Unë mendoj se ky vendim është deshtë së paku ta ketë një mbështetje për ta ditur se ku do të vendoset çerdhja, sepse nuk kemi asnjë informacion se ku do të vendoset çerdhja.

Si kërkesë e kam që për rrugën e cila është bërë me një kahe në “Dardani” nuk ka kuptim, sepse ka kuptim që në një sezon të jetë me një kahe ose në orët e mbrëmjes, por të bëhet me një kahe vetëm që t’ i mundësohet kafiterive dhe restoranteve për mundësi parkingu nuk ka kuptim! Mua më kanë dhënë vërejtje qytetarët pse është vepruar në këtë mënyrë! Në këtë rast vetëm bizneset kanë hapësirë më shumë.

Lutfi Haziri- unë e thash që projekti është në fazën ideore dhe ne kemi propozuar për të qenë dykatëshe për shkak të nevojave, sepse duhet të bëhet kategorizimi i fëmijëve. Nevojat për çerdhe të fëmijëve në Gjilan dihet sa janë, kurse ne po fillojmë për ta zbutur këtë nevojë? Një kat duhet për ta planifikuar për kategori të veçanta dhe duhet bërë plane detaje deri në kushte të ambientit.

Deri në javën e ardhshme ne do ta dimë saktë sa është vlera e projektit e cila vlerë me siguri nuk do të jetë e papërballueshme.

Ne jemi duke bërë përpjekje për ta menaxhuar zhurmën dhe në masë të madhe e kemi në kontroll këtë dukuri, por kemi probleme ende në dy pikë, por do të vazhdojmë deri në fund për ta menaxhuar dhe ta biem deri në atë pikë që mos pengohen qytetarët.

Mirëpo riorganizimi i trafikut në qytet është kompetencë e cila rregullohet në çdo kohë, por e kemi marrë iniciativën edhe te Xhamia e Vogël dhe do të vazhdojmë për ta bërë unazën e madhe sipas gjendjes faktike duke e ndal hyrjen nga Zabeli dhe rruga “Mulla Idrizi” në qytet e cila duhet të bëhet me një kahe, kurse dalja deri te rrethrrrotullimi në lagjen “Iliria” dhe në këtë mënyrë bëhet shkarkimi i qytetit.

Bajram Hasani- mbeta borxh për të thënë se e përkrahim këtë propozim.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon nga anëtarët e Kuvendit që të aprovohet pika 2.2. e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.2 e rendit të punës: Vendimin për caktimin e prioritetit në ndërtimin e institucionit parashkollor (Çerdhes së fëmijëve) në Lagjen “Dardania, me 23 vota të anëtarëve të Kuvendit (aq sa ishin të pranishëm), kurse kundër dhe abstenime nuk kishte.

2.3 Raporti financiar Janar-Qershor 2015,

Zijadin Maliqi- raporti është i formës standarde ashtu siç është përgatitur me vite të tëra, me planifikim të buxhetit me të hyrat e buxhetit, me shpenzimet analitike dhe sintetike.

Te të hyrat në raport që e keni ju është një gjendje pak më ndryshe, mirëpo për shkak se në raport nuk janë përfshirë gjobat e gjykatave e ku është një vlerë bukur e madhe e atyre, por të cilat ende nuk janë proceduar për të cilën arsye del se hyrat e planifikuara për këtë gjashtë mujor janë realizuar mbi 41%. Mirëpo krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar është 101%, do të thotë është për 1% më tepër se sa në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Te disa kategori kemi realizim të mirë të të hyrave, kurse te disa kemi ngecje, por unë gjithherë e kam thënë se planifikimi i buxhetit kur bëhet nuk bëhet për çdo muaj, por

bëhet për tërë vitin. Për këtë arsyeje ndodh që në një periudhë të hyrat mund të jenë më të mira, kurse në ndonjë periudhë më të ulëta.

Te tatimi në pronë nuk është realizmi në bazë të asaj që është planifikuar, por të hyrat më të mëdha nga kjo kategori realizohen gjatë muajit korrik, atëherë kur bashkatdhetarët tanë vijnë në pushime.

Te të hyrat nga biznesi ka ngecje bukur të madhe, por mendoj se planifikimi nuk është bërë ashtu si duhet, sepse planifikimi është i para disa viteve, kur kanë qenë të gjitha bizneset të ngarkuara me taksë komunale, kurse tash shumë biznese nuk janë të ngarkuara me taksë komunale.

Shpenzimet janë diku mbi 43% të buxhetit të planifikuar, kurse vetëm te pagat janë 50%, sepse pagat janë të përcaktuara për çdo muaj, kurse të gjitha kategoritë e tjera janë nën 50%.

Sipas kodeve buxhetore kemi shpenzime më të vogla e sidomos te mallrat dhe shërbimet dhe është bërë një reduktim i shpenzimeve aty ku ka pasur mundësi.

Te investimet kapitale del një vlerë e vogël prej 22% e buxhetit të planifikuar për këto investime, mirëpo për këto investime zotohen mjetet, por pagesa bëhet me përfundimin e punëve. Shumë investime kapitale janë në proces, kurse mjetet janë zotuar me kohë dhe në periudhën tjetër rritet kjo vlerë. Në përgjithësi mendoj se është një raport i mirë.

Riad Rashiti- në emër të grupit të PDK-së edhe ne po e japim vlerësimin tonë lidhur me raportin financiar për këtë gjashtë mujor. Në përgjithësi në këtë raport si me të hyra si me investime, kemi të bëjmë me vlerësime të njëjta dhe vlen të theksohet se kemi rënie të investimeve kapitale në përgjithësi, qoftë nga grandit apo të hyrat vetanake. Sa i përket të hyrave nga planifikimi i përgjithshëm e që janë mbi 3 milion e 850 mijë €, janë realizuar vetëm 39% e buxhetit të planifikuar. Gjithashtu në bazë të planifikimit për këtë gjashtë mujor nuk janë realizuar mbi 423 mijë €. Nga DAP kemi mos realizim të planit për 21 mijë €, ose janë realizuar 37% të të hyrave.

Nga bizneset janë 29 mijë € më pak se të planifikuarat, nga lejet e ndërtimit te urbanizmi janë 57 mijë € më pak realizim. Te Drejtoria e Shërbimeve Publike ka realizim të mirë të hyrave vetanake, sepse ka edhe tejkalim të të hyrave vetanake. Mirëpo rënie të madhe kemi te Inspeksioni, sepse janë realizuar vetëm 6% e të hyrave vetanake e që tregon më së miri se në çdo seancë e kemi ngritur problematikën e Inspeksionit, sepse kur nuk ka punë dhe angazhim nuk ka as të hyra. Te tatimi në pronë janë 132 mijë € realizim më pak se sa planifikimi i gjashtë mujorit të këtij viti. Te Shëndetësia kemi mos realizim të planit për 53 mijë € dhe vetëm 20% e planifikimit është realizuar në këtë periudhë. Ndërsa shpenzimet e realizuara nga grandit del që nga 8 milion e 902 mijë € që janë shfrytëzuar del që vetëm 474 mijë janë shfrytëzuar dhe investuar për investime kapitale e që do të thotë vetëm 5% e grandeve janë shfrytëzuar për shpenzime kapitale.

Gjithashtu edhe shpenzimet që janë bërë nga të hyrat vetanake janë në vlerë prej mbi 591 mijë €.

Në total janar –qershor për vitin 2015, janë shfrytëzuar vetëm 4% e mjeteve për investime kapitale. Këtij raporti i mungon lista e obligimeve dhe nuk e di pse drejtori nuk e ka sjell këtë listë dhe duhet të silllet lista e projekteve të cilat janë në realizim, cilat janë realizuar dhe sa është vlera e obligimeve të cilat i kemi ndaj kompanive. Do të duhej që këtij raporti financiar t' i bashkëngjitet edhe ky informacion bazik.

Sa i përket shpenzimeve nuk do të diskutoj gjatë, por Drejtoria e Inspeksionit ende figuron në listën e shpenzimeve, por ashtu edhe sporti dhe kultura figuron në listën e shpenzimeve sikur të ishte drejtori e veçantë edhe pse tash këto janë sektorë të Zyrës së Kryetarit të Komunës.

Për këtë arsyeje zyrtarët financiar duhet a gjejnë qasjen dhe mënyrën sa më të mirë për ta paraqitur raportin. Unë de disa javë i kam bërë kërkesë Drejtorisë për Financa për të marrë informacione të detajuara shtesë prej kësaj që na është dërguar në raport, por nuk kam marrë informacione, sepse ne kur e kemi shqyrtuar raportin në mënyrë analitike ne kemi ngrit pyetje shtesë si shqetësim tonin.

Sa i përket shpenzimeve për “Flakën e Janarit” janë shpenzuar mbi 31 mijë €, kurse në vitin e kaluar janë shpenzuar pak mbi 26 mijë €, që do të thotë se kemi shpenzime për këtë manifestim mbi 4 mijë € në krahasim me vitin e kaluar. Në bazë të kësaj shihet se shpenzimet nuk janë zvogëluar, por në përgjithësi shpenzimet janë të njëjta

Shpenzimet jashtë vendit janë të shpeshta shumë dhe në bazë të të dhënave zyrtare janë shpenzuar 35 mijë €, për këta 7 muaj.

Në vijim të fjalës së tij z. Rashiti pati vërejtje edhe për shpenzimet e mëditjeve, biletave etje e që në përgjithësi arrin shuma mbi 17 mijë €.

Shpenzime të tjera të mëdha ka edhe në kode të tjera siç janë për furnizim të zyrave me inventarë dhe kompjuterë e që kalojnë shumën mbi 100 e 11 mijë €.

Unë në fund po theksoj se buxheti i Komunës nuk po shpenzohet për investime kapitale, por mbi 80% po shfrytëzohet për paga, mëditje, mallra shërbime dhe shërbime komunale.

Krenare Latifi- unë e kam lexuar raportin i cili sipas meje në aspektin teknik është i hartuar mirë, kurse në aspektin përmbajtësor i kam disa vërejtje në të gjitha sektorët. Vetëm për mallra dhe shërbime për këtë gjashtë kam vërejtur se këto shpenzime janë rritur për 5 mijë € në krahasim me tre mujorin e parë. Po ashtu te participimi i qytetarëve dhe donacionet janë më shumë për 11 mijë 631 € në krahasim me tre mujorin e parë, vetëm për mallra dhe shërbime. Gjithashtu edhe në Drejtorinë e Administratës për mallra dhe shërbime janë shpenzuar nga 29 mijë e 469 € në 7 mijë e 901 € dhe kemi një diferencë të shpenzuar afër 78 mijë 432 € më shumë se në tre mujorin e parë. Edhe te Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik për tre mujorin e parë për mallra dhe shërbime janë shpenzuar 14 mijë e 257 €, kurse në tre mujorin e dytë janë shpenzuar në këtë drejtori për mallra dhe shërbime 64 mijë e 729 €, ose thënë më saktë pesë fish më shumë janë bërë shpenzime.

Po ashtu sa i përket realizmit dhe planifikimit të të hyrave vetanake për janar –qershor dhe fillimisht të hyrat në DKA nuk janë realizuar ashtu si është planifikuar, sepse i kemi diku rreth 170 mijë € të realizuara për vitin 2014 dhe ka qenë shuma mbi 68 mijë €, kurse në këtë gjashtë mujor janë inkasuar pak më shumë se 64 mijë € dhe shihet se nuk janë inkasuar më pak se viti i kaluar 4 mijë 800 €. Po ashtu edhe tek të hyrat nga biznesi dhe taksat komunale ku kanë qenë të planifikuara 150 mijë €, kurse të realizuara janë pak mbi 46 mijë € dhe në krahasim me vitin e kaluar kemi më pak të hyra për 3 mijë e 55 €.

Po ashtu edhe te Drejtoria e Kulturës janë planifikuar 14 mijë €, kurse janë realizuar në vitin e kaluar 7 mijë e 100 €, kurse realizmi i të hyrave për këtë periudhë është 4 mijë 679 € dhe po shihet edhe këtu është një mos inkasim i mjeteve në shumë prej 2 mijë e 482 € më pak se viti i kaluar. Gjithashtu kemi mos inkasim edhe te gjrobat në trafik, sepse janë planifikuar 320 mijë €, kurse realizimi për vitin 2014 ka qenë 158 mijë € dhe këtu kemi një diferencë mbi 3250 € Edhe në Inspeksion i kemi të planifikuara 45 mijë €, kurse realizmi për këtë mujor është pak mbi 3 mijë € dhe është një mos inkasim i mjeteve dhe është një diferencë prej 10 mijë e 200 € (më pak në këtë drejtori).

Të hyrat në Arsim janë planifikuar 240 mijë €, kurse realizmi për periudhë janar –qershor 2014 është 116 mijë €, kurse realizim të hyrave për këtë periudhë janar qershor për vitin 2015 janë pak mbi 112 mijë € dhe shihet se kemi mos inkasim në shumë mbi 3 mijë €.

Komuna e Gjilanit ka shpenzuar mjete në vlerë prej 34 mijë € për vizita të realizuara në vende të ndryshme cila vlerë është 7 mijë e 600 €, kurse për mëditje jashtë vendit janë

mbi 4 mijë €. Në fund shtrohet pyetja se këto vizita jashtë vendit çfarë dobie i kanë sjell këto vizita qytetarëve të Komunës së Gjilanit Komunës së Gjilani?

Ismet Hajdini – unë e kam një kërkesë për kolegët tanë që mos t' i përsërisin gjërat në raport e të cilat i kemi në tavolinat tona, sepse nëse kanë ndonjë vërejtje për të dhënë ta japin, por mos të bëjnë lexim të raportit të cilat i kemi pranë tavolinave tona. Ky është maltretim për neve, sepse nga 10-15 minuta po e lexojnë raportin të cilin e kemi të gjithë. Ju lutem të keni në konsideratë edhe kohën edhe efikasitetin?

Mevludë Zejnullahu- edhe ne si grup i AAK-së e kemi anuluar këtë raport dhe kemi konstatuar se ky raport është i përgatitur mirë dhe i koduar sipas programit. Mirëpo kemi konstatuar se realizimi i të hyrave është më i ulët se në periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Shpenzimi i të hyrave të realizuar në vlerë prej 591 mijë € është një vlerë e ulët e që në përqindje është 40% e vlerës së të hyrave në përgjithësi. Shpenzime kryesisht janë bërë në projekte kapitale dhe subvencione, mirëpo realizimi i të hyrave të bartura është bërë kryesisht në mallra dhe shërbime dhe në bazë të vlerave që kemi konstatuar më herët, realizimi i këtyre të hyrave është bërë në tërësi. Ne si grup i AAK-së e përkrahim këtë raport dhe shpresojmë se periudha e mbetur do të jetë më frytdhënëse në realizimin e të hyrave, por edhe në shpenzim të tyre.

Ilmi Limani- unë po përgjigjem në disa pyetje: të hyrat e Inspeksionit, por me ligj komunat e aprovojnë buxhetin deri më 30 shtator të vitit paraprak. Do të thotë buxheti në KK është aprovuar me 30 shtator, kurse Statuti i Komunës është ndryshuar më vonë. Për këtë arsyeje edhe këtë vit fiskal Inspeksioni është në programin buxhetor, si për të hyra si për shpenzime.

Sa i përket Drejtorisë së Kulturës nuk shkruan drejtori, por shkruan program.

Të hyrat janë direkte dhe indirekte dhe të hyrat direkte janë të gjitha të hyrat me përjashtim të gjobave të trafikut, gjobat e gjykatave dhe Agjensionit Pyjor të Kosovës. Planifikimi tërësishëm nga këto institucione është 515 mijë €. Nëse i krahasojmë të hyrat direkte e kemi një ngritje prej 1% në krahasim me vitin e kaluar. Të hyrat indirekte janë gjobat e gjykatave dhe gjobat e trafikut. Gjobat e trafikut kanë një rënie, sepse me Udhëzim administrativë është ndaluar që vozitësve t' iu konfiskohet patentë shoferi ose leja e qarkullimit. Gjobat e gjykatave janë krijuar, por ende nuk është bërë transferi. Nga kjo shihet se nuk ka rënie të hyrave, por është një ngritje e lehtë e tyre.

Te Inspeksioni vetëm në muajin janar dhe shkurt Inspeksioni ka vepruar si drejtori, kurse të hyrat nga Drejtoria e Zhvillimit Ekonomik janë mbi 10 mijë € dhe këto janë të hyra të Inspeksionit të Tregut e të cilat janë më të mëdha se të vitit të kaluar. Mirëpo në të gjitha drejtoritë ka ngritje të të hyrave dhe nuk mund të thuhet se ka zbritje të të hyrave.

Lutfi Haziri- i falënderoj të gjithë pjesëmarrësit në debat për këtë raport periodik financiar, por së pari po i sqaroj disa akuza që po bëhen publikisht. Nga pjesa e mëditjeve dhe udhëtimeve u tha 17 zyrtarë kanë marrë pjesë dhe janë mbuluar nga Zyra e Kryetarit. I fundit që ka marrë pjesë ka qenë Azem Mujku i cili ka marrë pjesë në programin për Eficiencë për energji elektrike i cili ka qenë në Kroaci dhe janë mbuluar të gjitha mëditjet nga ana e Zyrës së Kryetarit. Unë nuk i kam lejuar të gjitha letrat që vijnë në email dhe që kërkojnë të udhëtojnë vazhdimisht në emër të marrjes së mëditjeve. Nëse i krahasojmë kërkesat që na kanë arrit mund të them lirisht se raport është 2 me 8 në favor të mos aprovimit të kërkesave.

Sa i përket mjeteve nga dhuruesit, ne jemi një nga komunat e rralla që jemi në programin e Qeverisë Amerikane për pilotimin e donacioneve për investime publike në programin që

quhet “Qeverisje për qeverisje”. Mjetet vijnë drejtpërsëdrejti nga buxheti i Qeverisë apo i USAID-it në Qeverinë Komunale dhe me ekipe të përbashkëta e bëjnë zbatimin e programit.

Mjetet do të vijnë për herë të parë nga USAID-në qeverinë lokale, kurse ne do ta udhëheqim programin dhe parat e tyre. Kjo është arrit në sajë të një besimi të madh që është krijuar në menaxhimin e parasë publike. Harxhimet bëhen sipas një kalendari i cili imponohet, sepse në shumicën e rasteve përgjegjësinë për menaxhimin e projekteve e kanë donatorët dhe jo ne.

Për herë të parë një program që do të udhëhiqet një program i donatorëve është një Çerdhe e cila do të ndërtohet në “Dardani”. Ai që e udhëheq edhe e cakton programin, ne marrim pjesë me 1 anëtarë dhe pak para 10 apo 15%, por mjetet i menaxhon ai që i jep vetë. Ne do të bashkëpunojmë në këtë mënyrë edhe me Qeverinë Zvicerane, Austriake dhe Gjermane. Është e vërtetë se procedurat e dhuruesve janë të ngadalshme, por ky është realitet ashtu sikur ka ndodh me Komisionin Evropian me dy projektet të cilat kanë dështuar e që po i rifillojmë.

Sa i përket mobilimit nuk ka asnjë karrige dhe asnjë mobile që është blerë për Zyrë të Kryetarit, sepse unë i kam zhvendos komplet mobilet dhe komplet inventarin nga Zyra e ish kryetarit. Mobilimi është duke ndodhur për Këshilla të fshatrave, sepse këto këshilla janë zyra të Komunës dhe të komuniteteve, sepse ata kanë nevojë për të pasur zyra, salla për të pasur mundësi për të mbajtur takime.

Riad Rashiti- përkitazi me ato që i quajti kryetari akuza, unë po të mos kisha kërkuar 3 javë më herët informacione me shkrim nga Drejtoria për Buxhet dhe Financa, unë sot do t’ i kisha kërkuar publikisht kryetarit falje sikur të mos e kisha bërë kërkesën!

Tri javë më parë kam kërkuar për t’ i ditë shpenzimet të cilat janë bërë edhe jo vetëm për këtë rast, por edhe për kategori të tjera. Tri kërkesa, por asnjëherë nuk kam marrë përgjigje! Mos përgjigja në kërkesat tona reflektojnë në këtë situatë nganjëherë edhe acaruese.

Është mirë që ato projekte që janë realizuar nga grandet ose Qeveria, do të duhet që t’ i bashkëngjiti një listë raportit financiar për projektet që janë realizuar qoftë nga ministria, donatorët apo investitorët e tjerë. Nuk duhet të vini këtu me mungesë të informacioneve, pastaj këtu të thoni se janë bërë këto e këto projekte. Paraqitni punët e mira dhe projektet, sepse kjo është në interesin e juaj. Ne kur t’ i kemi informacionet nuk ngritim akuza të pabaza! Ne akuzat e pabaza i kemi përjetuar rëndë, sepse nuk ka qenë lehtë të t’ i përballosh akuzave se i kemi harxhuar 300 mijë € nëpër restorante dhe gjëja se i kemi pasur 10 milion borxh, kurse në fund nuk dolën as 3 milion. Është mirë të kihet kujdes dhe të jemi korrekt ndaj njëri tjetrit.

Lutfi Haziri- nuk dua të shkaktoj polemika, por mirë është që jemi ardh në atë pikë ku mundemi të sqarohemi. Nëse kërkesa është te shefi i Administratës ose diku tjetër, atëherë edhe unë jam në gjendje për të kërkuar falje për lëshimet të cilat i bënë zyra. Opozita ka të drejtë për të pasur qasje në çdo gjë që iu intereson, por duhet të jemi serioz në kualifikimet dhe paragjykimet. Vetëm njëherë këshilltarët komunal kanë udhëtuar në Komunën Vëllazërore të Bursës. Anëtarët e Kuvendit ende nuk e kanë shfrytëzuar të drejtën e daljes në shtetet e BE-së. Shtetet e BE-së e kanë mundësinë që edhe juve edhe neve të na ofrojnë programe më të mira. E dyta anëtari i Kuvendit z. Bajram Hasani është këtu dhe është njëri prej ndërtuesve në Gjilan dhe le të tregojë se a kam hise unë në këto ndërtime? Mirëpo Plani urban nëse ia jep dikujt të drejtën për të ndërtuar në pronën private në përputhje me ligjin, ai do të ndërtojë, unë askujt nuk ia ndalojë. Tregu e ka rregulluar këtë

çështje dhe nuk kërkoj asnjë favor kurrë prej askujt. Mirëpo duhet kuptuar se Gjilani do të fillojë të ndërtohet edhe në qendër të qyteti edhe në lagje, sepse ne nuk mund gjithherë ta shohim Gjilanin me shtëpi të ulëta. Gjilani do të ndërtohet me shtëpi më të mëdha 6,7 dhe 10 kate dhe kjo do të ndodh duke filluar me një ndërtim,mandej me dy, tri etj. Mirëpo kur e akuzon kolegu kolegun, atëherë është një çështje që unë nuk bëj ndaj askujt edhe sikur të kisha fakte, sepse janë organet tjera që duhet të merren me këtë punë. E përmendi z. Agushi pse kemi marrë vendim për ta ndal qarkullin e automjeteve për dy muaj gjatë orëve të mbrëmjes në qendër të qytetit dhe ky vendim nuk zbatohet. Mirëpo a mund të më garantoj dikush se një nën shtatzëne duke shkuar në spital mund të vdes në autoambulancë duke shkruar në Spital për shkak të mbylljes ë rrugës në qendër të qyteti?

Spitalit, zjarrfikësve nuk mund t' i mbyllet arteria kryesore për hir të bizneseve dhe unë këtë nuk e kam lejuar as për panairë. Kjo mund të ndodh kur organet e sigurisë e marrin përgjegjësinë për riorganizim.

Shpenzimet janë këto, të hyrat janë këto dhe unë do të vazhdojë punën me qeverisje të butë, sepse nuk besoj që qytetari i varfër e pasuron Komunën. Edhe më tepër besoj në amnisti që duhet të ndodh, besoj në lehtësime që duhet t' i kenë qytetarët, pro jo bizneset, sepse bizneset kanë mundësi për t' i shlyer obligimet së paku me periudha. Edhe puna e ushqimit jemi në proces të marrëveshjes me Thesarin për ta zgjidhur, sepse ne nuk jemi duke e penguar pagesën e 112 mijë € ushqim e që i ka mbi 50 mijë € “ Kristali” dhe operatorët e tjerë dhe ne jemi të interesuar për ta faktuar gjendjen me fatura dhe jo me komision. Ne e kemi dokumentin që është Komision komunal dhe në momentin e parë që dëshmohet Thesari deshëm apo nuk deshëm i paguan. Komision nuk ka të drejtë për të vërtetuar fatura, sepse nuk besoj që ka qenë Komision në atë moment kur është deshtë të bëhet fatura. Qeveria e ka vlerësuar si gjest të mirë pagesën e borxheve dhe ka propozuar si mundësi që Gjilanit t' ia mbulojë një numër të madh të borxheve. Në ato borxhe hyjnë edhe dëmet nga vërshimet si kategori dhe disa obligim të tjera që janë krijuar në ndërkohë.

Isa Agushi – z. Kryetar KK është organi më i lartë në Komunë të Gjilanit, ne kemi marrë vendim dhe ka qenë desh ta zbatoni vendimin e Kuvendit (është fjala për mbyllje të rrugës për automjete). E dyta e kam pyet kryetari dhe ju keni thënë po! Kryesuesja më ka thënë që të rekomandohet në komitet dhe unë e kam rekomanduar, ka kaluar në Kuvend, por nuk e keni zbatuar! Prandaj mos më akuzoni mua, sepse unë nuk kam faj!

E dyta polica dhe ndihma e parë në Perëndim edhe trotuarit kalojnë edhe rrugës me një kahe kalojnë vetëm për ta arrit cakun e duhur. Edhe pse t' i ishte mbyllur kjo rrugë për një muaj, nuk do të ishte punë e keqe, prandaj nuk është mirët ë thuhet se ky vendim nuk është marrë në mënyrë të rregullt. Unë bëra pyetje pse? Mirëpo tash e mora përgjigjen se ndihma e parë paska pasur pengesa?

Nevzad Isufi- pasi që është fjala për raportin kryetarit unë po bëj pyetje për disa shpenzime në arsim e të cilat nuk po duket se cilat janë? Unë kam pyetje për shpenzimet e renovimeve të zyrave të shkollave e të cilat në tërësi kapin shumën afër 48 mijë €, e që janë 6 shkolla, me përjashtim të Shkollës “Selami Hallaçi” e cila është pajisur me inventar për zyre, klasë bibliotekë dhe salla të arsimtarëve. Të gjitha të tjerat janë vetëm për zyra e që mesatarja i bie afër 8 mijë €. Mua më duket se është një shumë e madhe, sepse dihet se çka është inventari?

Ilmi Limani- sa për sqarim të z. Isufi po theksoj se MEF-i nuk ka paraparë kod të veçantë për karrige dhe banga, prandaj DKA po sistemon në këtë kategori.

Lutfi Haziri- unë sa për sqarim të z. Agushi, unë e respektoj vendim e Kuvendit, por zbatimi ka të bëjë deri në gjetjen e solucionit me polici për të kaluar këtë situatë. Nëse gjendet një rrugë i referohet situatave, menjëherë zbatohet vendim dhe krijon qarkullim të lirë për njerëz dhe aktivitete të tjera si janë panairët. Sa i përket udhëtimeve unë po e përmendi një fakt se vetëm një zyrtar për menaxhim të mbeturinave në Bullgari ka shkuar pa leje, kurse në të gjitha rastet e tjera unë i kam zvogëluar delegacionet dhe i kam përzgjedh ata më përgjegjës që janë për sektorë. Ky zyrtarë i cili ka shkuar në Bullgari ka qenë jo korrekt dhe ka krijuar kushte për suspendim, por unë nuk e kam marrë këtë masë për shkak që të mos keqkuptohem dhe mos të kualifikohet si rast politik.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.3. e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.3 e rendit të punës: Raporti financiar Janar-Qershor 2015, me 21 vota të anëtarëve të Kuvendit , kurse të tjerët abstenuan.

2.4 Rekomandim i Komitetit për Shëndetësi dhe MS për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare: QKMF “Dr. Nagip Rexhepi”

Për ta arsyetuar këtë rekomandim të Komitetit për Shëndetësi, kryesuesja ia bartë fjalën dr. Jashar Jasharit i cili është edhe kryesues i këtij komiteti.

Jashar Jashari- të nderuar anëtarë të Kuvendit të Komunës, veprimtaria e shëndetësisë në Komunën e Gjilanit për dekada me radhë ka rrugëtuar bashkë me personalitete që me punën e tyre kanë dhënë kontribut të çmuar për ditën ku jemi sot. Pa dyshim që edhe Nagip Rexhepi dhe vepra e tij prej humanisti dhe profesionisti të dëshmuar e rreshton në mesin e figurave të çmuara që dhanë kontribut në lëmin e shëndetësisë.

Duke pasur parasysh këtë fakt një numër i madh i punëtorëve shëndetësorë, në shenjë respekti për veprën e madhe të tij kanë dhënë idenë që QKMF në Gjilan të mbajë emrin e Dr. Nagip Rexhepi.

Në vijim të fjalës së të dr. Jashari e lexoi Biografinë e dr. Nagip Rexhepit e cila biografi iu është dorëzuar me shkrim anëtarëve të Kuvendit në material të seancës i cili rekomandim është nënshkruar nga 160 punëtorë shëndetësor të Komunës së Gjilanit, kurse një kopje e rekomandimit të Komitetit për Shëndetësi së bashku me nënshkrimet e punëtorëve shëndetësor iu është dorëzuar Njesisë së Kuvendit e që do të jetë si dokument në arkiv të kësaj njësie.

Isa Agushi- në emër të grupit të anëtarëve të LDK-së ne e përkrahim këtë rekomandim dhe do ta votojmë.

Izmi Zeka- kur është fjala për emërtim të institucioneve, ndjeshmëria është më e madhe, por edhe po thuhet se procedurat janë zbatuar. Po thuhet janë 160 nënshkrime për këtë propozim , por mendoj se do të duhej të ishte bërë një komision i specializuar dhe të ishin propozuar 3-4 emra, pastaj të ishte bërë një analizë e biografive këtyre personaliteteve do të kishte qenë më transparente. Mirëpo nuk dua të keqkuptohem, unë kam respekt për këtë personalitet, kam respekt për familjen e tij, mirëpo mënyra dhe qasja si po veprojmë (jo vetëm në këtë rast) po krijojmë një rrugë e cila është e papresedant edhe për mua. Po krijojmë një rrugë që nesër një fuqi politike tjetër ta bie një emër sipas shijes së saj. Me institucione të rëndësishme si shkollat, institucionet shëndetësore duhet pasur kujdes se si po veprojmë, sepse Gjilani ka pasur mjek me renome dhe së paku një komision ka qenë

desh të formohet dhe t' i propozoj 3-4 emra dhe të debatohet në Kuvend. Në këtë mënyrë edhe nesër mund ta bini një emër, sepse e keni numrin e votave. Ne si PDK do të abstenojmë, jo pse jemi kundër personalitetit të Nagip Rexhepit, por po e them se edhe nesër do të vijnë emra këtu dhe nuk do të dimë se si të veprojmë? Kryetari i Komunës ka udhëtuar mjaft, ka parë dhe e dinë mirë se si institucionet emërohen dhe si zgjidhen ato personalitete. Unë e thash qëndrimin e PDKK-së ne do të abstenojmë, por uroj që herëve të tjera mos të na sillni në këso pozite.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- për këtë rast janë zbatuar procedurat në tërësi dhe në Komitetin për Shëndetësi pozitiv dhe opozitiv kanë votuar, por edhe në KPF gjithashtu pozitiv dhe opozitiv kanë qenë për, përveç z. N. Isufi. Nga PDK po e them me emër se z. Abazi dhe z. Nevzadi kanë votuar për. Ne herën e parë në KPF këtë rekomandim e kemi kthyer për shkak të moszbatimit të procedurave, kurse herën e dytë janë zbatuar procedurat, ka ardhur propozimi në Kuvend dhe sot po debatojmë.

Selami Xhemajli- unë po e konfirmoj atë që e kemi thënë edhe në KPF dhe e përkrahim propozimin që QKMF të emërtohet me emrin e Nagip Rexhepit.

Nevzad Isufi- unë e kam thënë qëndrimin edhe në KPF, por edhe tash po e them para Kuvendit që nuk është fjala për figurën për të cilën po bëhet fjalë, por as që po vemi në dyshim kontributin e tij, por në pikëpamje ligjore dhe procedurale nuk kemi pasur informacione dhe procedura të duhura. Nuk kemi pasur më shumë propozime, nuk kemi ndonjë rregullore në të cilën do të thirrem për emërtim të institucioneve. Ashtu si po veprohet vetë ju do të bindeni se nuk po krijohet një rregull e mirë në këtë aspekt dhe për këtë arsyeje edhe ne për pa e kontestuar asnjë vlerë të emrit në fjalë pa e vënë në dyshim kontributin e tij, për çështje parimore ne abstenojmë për këtë rekomandim. Arsyeje e abstenimit është për shkak se nuk janë zbatuar procedurat e duhura ligjore

Lutfi Haziri- natyrisht se grupet politike kanë votuar, por kjo ka të bëjë me iniciativë të qytetarëve (mjekëve). Peticion i qytetarëve është ky i cili është përcjell përmes zyrës sime në Komitetin për Shëndetësi. Iniciativa e qytetarëve ka qenë për një person, kurse unë si kryetar i Komunës nuk e kam marrë asnjë iniciativë për emërtime, riemërtime apo ndryshime eventuale për këto raste. Unë po e theksoj se ne kemi emërtime në mënyrë arbitrare që kanë ardhur nga vendet tjera në Gjilan. E tërë kjo është në rregull, por duhet ta dini që propozimi është i mjekëve dhe kolegëve të tij. Unë e kam iniciuar procedurën për një rregullore të tillë dhe iu lus që të merrni pjesë. Ka propozime për vendosjen e busteve për vendosjen e lapidarëve dhe zhvendosjen e tyre, por një komision i cili punon në këtë rregullativë dhe vlerësime. Ky komision duhet të jetë gjithëpërfshirës, gjithë partiak, në mënyrë që për gjithçka që vendosim mos të ketë ndryshim.

Shukrie Rapuca- po e them shkurtimisht se kam shumë respekt për këto personalitete me emrin e të cilëve po emërtohen institucionet. Mirëpo e kam një vërejtje të madhe për të gjithë ne, sepse jemi Kuvend që duhet ta japim kontributin tonë, por nuk duhet të marrim vendime për emërtim të institucioneve me nguti dhe pa analizë dhe pa mendim të ekspertëve. Në këtë mënyrë po krijojmë hapësirë për gabime dhe po lëndojmë familje dhe familjarë të Gjilanit. Unë nuk e kam fjalën vetëm për sot, sepse edhe në qeverisjet e mëparshme u bënë disa emërtime, por erdhi një pushtet tjetër dhe i hoqi disa emërtime pa asnjë të drejtë dhe pa asnjë kriter dhe në këtë mënyrë i bëmë disa lëndime dhe ofendime disa familjarëve. Mendoj se duhet pasur kujdes për këto gjëra, sepse kjo është një punë e

ndjeshme dhe po bëhet shkel e shko. Edhe ne kemi pasur iniciativa qytetare, por nuk janë marrë për bazë, sepse jemi thirr në diçka që është më madhore duke e bërë një analizë më të mirë, prandaj e kam dronë se do ta pëson edhe ky emërtim ashtu siç jemi dëshmitar të disa rasteve të tilla që na kanë ndodhur.

Valentinë Bunjaku-Rexhepi- unë edhe njëherë po përsëris se z. Abazi shef i grupit të PDK-së i ka dhënë përkrahje të plotë këtij propozimi në emër të PDK-së.

Izmi Zeka- si ka votuar z. Abazi është çështje tije, por edhe një çështje nuk dua të më keqkuptoni se unë jam kundër këtij emri, por për hir të një procedure e cila ka desh të udhëhiqet dhe për arsye se po krijojmë një presedant, sepse mund të dalin propozime në vazhdimësi. Unë e thash një komision po të kishte qenë pa marrë parasysh prej iniciativës që është bërë ky komision do ta vlerësonte, ne do të kishim votuar dhe do të përfundonte kjo çështje.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja kërkon që të aprovohet pika 2.4 e rendit të punës?

Aprovohet pika 2.4 e rendit të punës: Rekomandim i Komitetit për Shëndetësi dhe MS për emërtimin e Qendrës Kryesore të Mjekësisë Familjare: QKMF “Dr. Nagip Rexhepi, me 18 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerët abstenuan, kurse prezent në seancë ishin 27 anëtarë të Kuvendit.

2.5 Propozim vendimi për shfuqizimin e Vendimit 01.Nr.16-24249 dhe Vendimit 1.Nr.16-24255 të datës 15.03.2013

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – pika 2.5, 2. 6 dhe 2.7 janë të ngjashme dhe kanë një tematikë, prandaj po e hapi debatin për të tri pikët.

Riad Rashiti- ju vendosët që t’ i shqyrtoni të tri pikët në pako, por pika 2.5 për ne ve është e paarsyeshme dhe e pabazuar, sepse nuk ka arsyeje për t’ i anuluar këto dy vendime të dy komisioneve. Nuk ka qenë mirë fare të formohen këto dy komisione, sepse qenka lehtë për të vepruar me iniciativa qytetare dhe nënshkrime mund të merrni vendime si në rastin paraprak, mos formoni komisione fare.

Nevzad Isufi- propozoj që të mos nguteni, sepse jo rastësisht i keni ndarë si pika të veçanta dhe mendoj si pika të veçanta duhet të debatohen dhe mos të bëjmë shkelje pa nevojë. Ne propozojmë që në këto komisione të mos jenë njerëz të cilët kanë dëshmuar se nuk kanë qenë aktivë në këtë komision. Unë propozoj që të votojmë veçmas për secilën pikë dhe të propozojmë të tjerë kandidatë dhe jo ata që janë aktualisht në këto komisione.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi – komisioni i mëparshëm nuk ka qenë funksional, kurse ne e kemi formulën për ta formuar këtë komision si pas çelësit partiak. Nga partitë politike duhet të jenë 5 anëtarë, një nga shoqëria civile dhe një nga Shoqatat e Dala nga Lufta një anëtar, gjithsej 7 anëtarë.

LDK i dërgon dy emra, PDK një, LVV një, Shoqatat e Dala nga Lufta, një, Shoqëria civile një, një Komiteti për Barazi Gjinore.

Izmi Zeka- kërkoj nga të gjitha partitë që të dërgojnë ekspert në këtë komision, sepse nëse nuk janë ekspertë do të kenë problem për ta bërë edhe vlerësimin edhe vendosjen e lokacioneve.

Valentinë Bunjaku – Rexhepi – pajtohem në tërësi me diskutimin e z. Zeka, prandaj po i japim dy ditë afat partive politike për t’ i dërguar emrat e njerëzve për këto komisione, në Sekretari të Kuvendit.

Mirëpo mendimi i im është ky komision t’ i ketë 9 anëtarë dhe jo shtatë, prandaj a jeni të pajtimit që komisioni t’ i ketë 9 anëtarë.

Kuvendi u pajtua që komisioni t’ i ketë 9 anëtarë.

Bajram Hasani- të gjitha subjektet e tjera janë në koalicion, prandaj propozoj që edhe subjekti “Nisma “ të ketë një anëtar në këtë koalicion.

Nuk pati debatues të tjerë, kurse kryesuesja theksoi se formula për formimin të këtij komisioni u propozuar sipas çelësit partiak, prandaj iu lus që të deklaroheni se kush është për aprovim të pikës. 2.5, 2.6 dhe 2.7.

Aprovohet pika: 2.5, 2.6 dhe 2.7 me 20 vota të anëtarëve të Kuvendit, kurse të tjerat ishin abstenime.

2.8 Informatë rreth Manifestimit “Flaka e Janarit” 2015

Bujar Haziri- informata është dërguar me shkrim, prandaj nëse ka ndokush ndonjë vërejtje ose sugjerim ose ndonjë pyetje, mund t’ i përgjigjem.

Nevzad Isufi- unë propozoj që për këtë manifestim të epet raport dhe jo informatë siç po quhet, sepse në Kuvend raportohet, por edhe elementet për aktivitetin e këtij manifestimi janë të raportit.

Valentinë Bunjkau – Rexhepi – është kërkuar informatë dhe informata është sjell dhe nuk ka nevojë të aprovohet, por vetëm të diskutohet.

2.9 Informatë mbi aktivitetin gjashtëmujorë të KKSB-së

Edhe informata për aktivitetin e KKSB-së, anëtarëve të Kuvendit iu është dorëzuar me shkrim, kurse anëtarët e Kuvendit nuk patën ndonjë vërejtje ose sugjerim

Të ndryshme

Ismet Hajdini – unë kam një pyetje për DUMM dhe të Kadastrit dhe ajo ka të bëjë përkitazi me lokacionin e varrezave të qytetit. A është duke u punuar në këtë drejtim, sepse ky është një ndër problemet më të mëdha dhe është mirë që kjo problematik të debatohet si pikë e veçantë në një seancë të Kuvendit.

Fehmi Sylejmani- gjatë debatit të kësaj seance u përmenden qentë endacak, por nuk u përmenden edhe qentë të cilët janë me përcjellje, por të cilët janë pa maska e të cilët mund të jenë shumë të rrezikshëm e të cilët shëtisin në park të qytetit, aty ku ka qarkullim të madh të qytetarëve.

Gjithashtu edhe drejtori për Mbrojtje dhe Shpëtim të na jep një informatë për zjarret në fshatin Zhegër? Gjithashtu duhet përmendur se bastoret, kazinotë dhe lojërat e fatit serish

janë kthyer në vendet e mëparshme dhe nuk zbatohet neni i ligjit i cili thekson se duhet të jenë 500 m larg institucioneve ose 300 m larg njëra tjetrës.

Ibish Ibishi- në fillim të seancë z. Isa Agushi e potencoi problemet që janë evidente në Eco-Higjienë e të cilat patjetër duhet të diskutohen. Në këtë kompani edhe më herët ka pasur probleme e dinë këtë të gjithë ne që jemi këtu nga mandatet e mëparshme, por edhe tash kemi probleme me të cilat duhet të merret ky Kuvend, por edhe ata të cilët merren me këtë punë.

Ka kaluar një vit që është formuar një komision (i aksionarëve) e të cilët ka qenë deshtë që të përpilojnë një raport për të na njoftuar se çka po ndodh atje? Është një kohë e gjatë që në këtë Kompani nuk ka drejtor, por është një u.d, kurse vendimet i merr një zyrtar i quajtur Suad e të cilit nuk ia di mbiemrin i cili thirret se është përfaqësues e aksioneve të Austrisë. Vendimet nuk mund të merren vetëm prej një personi dhe është fjala për kontrata tremujore e që nuk jam në njohuri se duhet të ketë kontratë tre mujore në një kompani, sepse ata punëtorë të cilët kanë më tepër se 10 vjet përvojë pune. Nuk duhet lejuar që një zyrtar (Suad) të sillt si mbret në këtë kompani, sepse ajo kompani është e Komunës, kurse sipas kontratës që ka qenë e paraparë për t' u bërë investimet nuk është përmbush ajo kontratë as 20%. Në seancën e radhës kërkoj që të jetë një pikë e rendit të ditës për problemet e Kompanisë Eco-Higjienë”.

Një pyetje për kryesuesen, sepse ka pas premtuar se me rishikim të buxhetit do të rriten pagat e anëtarëve të Kuvendit, por deri më sot nuk është përmbushur ky premtim? Kryesuesja aktualisht nuk qenka në sallë, por besoj se do të njoftohet dhe do të na ep një përgjigje?

Zijadin Maliqi- drejtori i Zhvillimit Ekonomik nuk qenka në sallë, por me sa e di unë në shtator me sa e di unë duhet të jetë edhe raporti i punës së Eco-Higjienës.

Ibish Ibishi- e kam një frikë se deri në shtator ky person i quajtur Suad do t' i largojë nga puna së paku 12-13 punëtorë. Ky njeri ka nxjerr kontrata të paligjshme, por edhe nuk duhet ky njeri t' i lëshojë kontrata punëtorëve.

Nevzad Isufi – unë e kam një pyetje për drejtorin e Arsimit: është fjala për transferimet të cilat po bëhen pa konkurse prej një shkolle në shkollën tjetër dhe për këso parregullsi ka qenë edhe një ankesë dhe ka qenë një shqetësim i madh. Unë e lus drejtorin që ta bëjë rishqyrtimin e kësaj ankese dhe të veprohet sipas rregulloreve dhe ligjeve.

Problem tjetër është rruga me një kahe te Shkolla “Selami Hallaçi” e cila është bërë kokë në vete dhe pa konsultimin e askujt. Pa konsultim të qytetarëve, pa rekomandimin e asnjë komiteti, por edhe pa pëlqimin e këtij Kuvendi. Kush ka të drejtë që për hir të një biznesi të shkel mbi interesin e shumicës së qytetarëve. Kjo është kryesisht zonë e banuar dhe banorët janë ata të cilët duhet të marrin vendim.

Gjatë debatit u përmend edhe shkolla në fshatin Haxhaj me plotë të drejtë, sepse ajo shkollë është jashtë çdo kriteri për të qenë objekt i sigurt dhe kjo shkollë do të duhej të futet në prioritet për ndërtim të një shkolle të re.

Isa Agushi- unë po e përkrahi z. Ibishin për rastin e Eco-Higjienës, sepse unë kam informata nga punëtorët të cilët punojnë aty se aty është një “sulltan” i cili jo vetëm 51%, por 100% ai e menaxhon dhe bën çka të dëshirojë ! Unë mendoj se urgjentisht duhet të ndërmerret diçka e të vijë komisioni i aksionarëve të raportojë për gjendjen faktike si është sot. Unë e di që është anarki totale, punëtorët kërcënohen dhe përjashtohen nga puna,

sepse e di një rast me emër dhe mbiemër të cilit i ka dhënë afat një muaj për t' larguar nga Kompania. Unë nuk kam parë se Komuna ka pasur kontroll ndonjëherë në këtë kompani, prandaj së shpejti Komisioni duhet të vijë para Kuvendit të raportojë se çka po ndodh aty, sepse ne e kemi zgjedh atë komision.

Fehmi Sylejmani – pyetja e dytë ka të bëjë me TV- “Valin” e cila e bënë transmetimin e seancave të Kuvendit, por tash TV “Vali” nuk i transmeton në kohën e pas ditës, prandaj kërkojmë për ta ditur se si e keni marrëveshjen me TV “Valin”? Gjithashtu seancat nuk janë duke u vendosur në faqen zyrtare të Komunës në tërësi. Mundësisht që të kërkonti që seancat të jenë komplet në faqen zyrtare?

Valentinë Bunjaku- Rexhepi – përveç Radio “Star” e cila i përcjell seancat deri në fund, ne kemi marrëveshje edhe me TV “Valin “ për ta përcjell seancën deri në fund, por ata vijnë në fillim të seancës dhe nuk janë gjatë të kohës këtu. Vërejtja është me vend, por unë do t' i drejtohem me shkrim TV ” Valit”

Zijadin Maliqi- atë që e kam vërejtur unë ashtë se TV “Vali” ka një kohë të gjatë që është jashtë platformës së IPK-os. Është e kotë edhe pse e përcjell punën këtu!

Ramiz Ramadani- unë në emër të drejtorëve kërkoj që 30 minutat e para të seancës deri sa të fillojmë me rend të punës, ta shfrytëzojmë për pyetje dhe përgjigje. Nuk ka kuptim të na bëhen pyetjet në fillim, kurse ne të presim 5-6 orë për të dhënë përgjigje.

Valentinë Bunjaku- Rexhepi- drejtorët nuk janë duke qëndruar në sallë, por janë në Kuvend, sepse Kuvendi mbahet njëherë në muaj dhe kjo të mos quhet pritje.

Ismail Jonuzi – pyetjet të cilat u bën për Zhvillim Ekonomik u përgjigj drejtori i kësaj drejtorie z. Ismail Jonuzi.

Me këto debate dhe vendime seanca i përfundoi punimet në ora 17.30 min.

Procesmbajtësi

Kryesuesja e Kuvendit

Sali Hasani

Valentinë Bunjaku- Rexhepi